



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DITARI MUJOR DHJETOR 2024



Gara çiklistike "Giro d'Italia" vjen në Shqipëri në muajin maj

"Giro d'Italia" një nga aktivitetet më të famshme çiklistike në botë, zgjodhi Shqipërinë mes shumë kandidatëve për të zhvilluar "La Grande Partenza 2025" - "Nisjen e Madhe 2025". Gara e famshme popullore, me një traditë 114-vjeçare, do të mbledhë në muajin maj çiklistët më të mirë të botës, që do të ndjekin itinerarin e garës së tyre në Tiranë, Durrës dhe Vlorë. Një ngjarje që pritet të ndiqet nga mijëra shikues e qindra milionë teleshikues, duke ndikuar në promovimin e Shqipërisë dhe në zhvillimin turistik dhe ekonomik të vendit.

Mbi 20 mijë libra artistikë po pasurojnë bibliotekat e shkollave

Mbi 20 mijë libra artistikë janë shpërndarë në shkollat e Shqipërisë, si pjesë e procesit të pasurimit të bibliotekave me tituj të rinj, me një fond prej 19 milionë lekësh, vënë në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Janë vepra të autorëve shqiptarë e të huaj, të përzgjedhur nga një listë prej 764 titujsh, të hartuar nga MAS në bashkëpunim me mësues e specialistë të fushës, por edhe me shtëpitë botuese për të ofruar jo vetëm një larmi titujsh, autorësh shqiptarë e të huaj, tematikash, por edhe të hapur e transparente.



Rezultatet e TIMMS 2023, nxënësit shqiptarë mbi mesataren ndërkombëtare

Nxënësit shqiptarë renditen në listën e 14 shteteve me rezultate në rritje në matematikë dhe në listën e 15 shteteve me rezultate në rritje në shkencë në Vlerësimin Ndërkombëtar TIMSS 2023. Shqipëria renditet për herë të parë mbi mesataren ndërkombëtare në matematikë, duke shënuar një progres të dukshëm në matematikë dhe shkencë. Ky vlerësim, i cili përfshiu në vendin tonë 200 shkolla dhe 5143 nxënësit të klasës së katërt, u zhvillua për herë të parë në format digjital (CBA). Shqipëria për herë të parë shënoi një rezultat prej 512 pikësh në matematikë, ose 9 pikë mbi mesataren ndërkombëtare që është 503 pikë.

Prezantohet Korniza e re Kurrikulare, i përshtatet zhvillimit digjital

Së bashku me mësues e pedagogë u prezantua nisja për kornizën kurrikulare të përditësuar të arsimit parauniversitar. Korniza e re do t'i përgjigjet zhvillimeve ekonomike, sociale dhe teknologjike të vendit, me qëllim që të rinjtë të jenë të pajisur me kompetencat e duhura për t'u përballur me sfidat që i presin pas shkollimit. Kjo kornizë do të çojë përpara arritjet e kornizës kurrikulare të vitit 2014, duke u përshtatur metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe përbushjen e synimit për një sistem arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës.



Plani i Veprimit për Sigurinë në shkolla, mbyllet Tik-Tok për një vit



Pas 1300 takimesh në çdo shkollë të vendit, me pjesëmarrjen e rreth 65 mijë prindërve, u vendos mbyllja për një afat 1-vjeçar e platformës online Tik-Tok. Fushata e këshillimit kombëtar me mësuesit e prindërit për sigurinë kibernetike dhe fizike të fëmijëve në shkolla u përmbyll me prezantimin e Planit të ri të Veprimit. Përmes këtij plani gjithëpërfshirës, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, së bashku me aktorët dhe partnerët e saj, do të ndërmarrim masa konkrete afatshkurtra dhe afatmesme për të fuqizuar dhe zhvilluar më tej mekanizma të qëndrueshëm të sigurisë në shkollë, të cilët shtrihen në disa rrafshë, që nga kuadri ligjor te forcimi i rolit të mësuesit, i rolit të prindit, modernizimi i kurrikulave, fuqizimi i shërbimeve të oficerit të sigurisë dhe të punonjësit psiko-social.

KËRKIMI SHKENCOR, U HAP THIRRJA PËR PROJEKTE PËR VITIN 2025

U hap thirrja për projektet e kërkimit shkencor dhe inovacionit për vitin 2025. Këtë vit thirrja u hap më herët për t'u dhënë më shumë kohë dhe mundësi të gjithë universiteteve dhe kërkuesve shkencorë të hartojnë projekte sa më të suksesshme. Buxheti i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, dedikuar këtyre thirrjeve, për vitin 2025 ka shënuar një tjetër rritje. Në dispozicion të tyre është vendosur një fond prej rreth 600 milionë lekësh, ose rreth 100 milionë lekë më shumë se një vit më parë, duke krijuar më shumë mundësi dhe hapësira jo thjesht për realizimin e më shumë projekteve, por mbi të gjitha të projekteve cilësore dhe të konkurrueshme edhe në arenën ndërkombëtare.



MEDALJET E ARTA, VLERËSOHEN 188 ISH-MATURANTË TË SHKËLQYER

Në Sallën e Hartave në Kryeministri u zhvillua ceremonia e dhënies së "Medaljes së Artë" për 188 ish-maturantë që kanë përfunduar gjimnazin me 10 absolute. Janë ish-maturantë nga e gjithë Shqipëria, sot studentë të shkëlqyer në degët e përzgjedhura, kryesisht në shkencat mjekësore dhe inxhinierike, ku shumica janë vajza (116). Rreth 70% e medalistëve (132 maturantë) kanë zgjedhur universitetet tona, ndërsa pjesa tjetër kanë zgjedhur institucione të arsimit të lartë jashtë vendit.